



01/Nr. 2743 2024
Data : 08.04.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.03.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit), **Lumni Berisha** (Ushtues Detyre në QKMF), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
3. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.
4. Propozim vendim për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 për Komunën e Hanit të Elezit.
5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022.
6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
7. Raportimi i punës së Këshillave Lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës të cilat ua kemi përcjell kemi edhe një pikë shtesë propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, propozim vendimimi për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
3. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.
4. Propozim vendim për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 për Komunën e Hanit të Elezit.
5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022.
6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
7. Raportimi i punës së Këshillave Lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.
8. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hyriete Isufi thekson:- në raport te muaji mars shënon se pika numër dy nuk është diskutuar për shkak të mungesës së personit në fjalë, ndoshta kanë mundur me shtyrë për ndonjë ditë tjetër.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Statuti i QKMF-së –Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lumni Berisha thekson:- sa i përket statutit të QKMF-së kemi dy pika që duhet ti ndryshojmë, bëhet fjalë për këshillin drejtues dhe neni njëmbëdhjetë që ka të bëjë me përfaqësuesin e këshillit të pacientëve që na nuk e kemi zgjedhur. Pika tjetër ka të bëjë me kompetencat dhe detyrat e këshillit drejtues që parashihet edhe zëvendës drejtori, mirëpo zëvendës drejtori është i paraparë nëse është numri mbi njëqind i personelit në QKMF që na nuk i kemi dhe duhet me fshi këtë pikë.

Hyriete Isufi thekson:- duke e shfletuar materialin lexova fjalën për pedodonësia por kërkoj sqarim se për çka bëhet fjalë.

Lumni Berisha thekson:- kjo është në kuadër të defektologjisë që ka të bëjë për fëmijët të cilët janë me të meta dhe na nuk e kemi.

Sherif Berisha thekson:- afatet të cilat janë të caktuara janë të parapara se kurë duhet të kryhet por kush është pikë kontakti për këta që i potencove për me i bërë ndryshimet.

Lumni Berisha thekson:- secila komunë e miraton dhe i shikon interesat e veta se çka ka . Pikat i potencova që ne si QKMF nuk mundemi me i realizuar.

Sherif Berisha thekson:-deri në kuvend a do të bëhen këto ndryshime dhe kush është ura lidhëse me nivelin qendrorë se materiali ka ardhur prej nivelit qendrorë .

Lumni Berisha thekson:-kjo do të përcillet në Ministri dhe ata e dinë që ne nuk i kemi njëqind punëtorë .

Kryesuesi thekson:-është mirë me u konsultuar me drejtoreshën dhe ndryshimet me i bërë me kohë se materiali përcillet për kuvend. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU STATUTI I QKMF-së –HANI I ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4.Propozim vendim për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 për Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:-plani lokal për cilësi të ajrit është obligim ligjorë dhe në këtë drejtim ne e ekmi hartuar me mbështetje teknike të Uendipisë . Plani është hartuar në pajtim me dispozitat ligjorë të Ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Po ashtu ky plan ka me dalur në diskutim publik dhe diskutimi publik zgjatë tridhjetë ditë. Plani është hartuar nga grupi punues i komunës por më shumë me mbështetjen teknike të ekspertëve të Uendipisë dhe ka vend edhe për korrigjime dhe për këtë arsye bëhet edhe diskutimi publik.

Hyriete Isufi thekson:- faqe njëzetë shënon se për shkak se përdorimi i automjeteve me regjistrim më pak se euro tre dhe katër është më i madh se pesëdhjetë përqind. Te të dhënat meteorologjike shënon se Hani i Elezit ka klimë kontinentale.

Nexhmedin Daci thekson:- në komunën tonë në bazë të dhënave ekzistuesi diku më shumë se pesëdhjetë përqind janë automjete të vjetra me euro tre pra janë klasifikime në bazë të djegëjes së lirim të komponentëve të dëmshme. Pjesa më e madhe e të dhënave janë marr prej agjensionit mjedisorë.

Kryesuesi thekson:-ndotësit më kryesorë kush janë.

Nexhmedin Daci thekson:- te plani lokalë për cilësi të ajrit edhe te objektivat edhe te aktivitetet Sharrcemi praktikisht është përjashtuar për shkak se ne nuk kemi atje kompetencë me ndikuar sepse është kompetencë e Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë dhe përqendrimi jonë ka qenë më shumë për ndotjen nga transporti, ndotja nga përdorimi i masës drusore për ngrohje, te mbeturinat që do të thotë në ato fusha ku na si komunë kemi mundësi për me ndërmarr hapa konkret për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Sharrcemi nuk përjashtohet dhe është një pjesë e dedikime për Sharrcem por nuk mundemi me paraparë si komunë ndonjë aktivitet për Sharrcemin sepse është kompetencë e Ministrisë së planifikimit Hapësinorë.

Sherif Berisha thekson:-edhe më herët kam pasur propozim por edhe tash po propozoj që në të ardhmen të planifikohet në buxhet që të caktohet një person prej komunës i drejtorisë përkatëse për ndotje të ajrit që të bëhet vlerësimi dhe matjet por edhe gjitha në mënyrë që të kemi material të saktë.

Nexhmedin Daci thekson:- draft plani për cilësi të ajrit ka me dal në shqyrtim publik dhe kush do që ka ndonjë propozim mund ta parashtron. Sistemet i kanë për matjen e ndotjes në Sharrcem dhe ato sisteme kontrollohen prej Institutit Hidrometrologjik të Kosovës sepse Ministria e Planifikimit Hapësinorë është përgjegjëse dhe rezultatet e matjes publikohen rregullisht.

Kryesuesi thekson:- qëllimi është për me përmirësuar por dëshira është e madhe e mundësit ndoshta janë më të vogla, mirëpo Sharrcemi është një ndër ndotësit më kryesorë i cili e ndotë Hanin e Elezit dhe nuk duhet të hynë në grupin e transportit për shkak se brenda njëzet e katër orëve mundesh me bërë matje se sa ndotë Sharrcemi.

Nexhmedin Daci thekson:-në plan e ke një pjesë për çështjen e Sharrcemit por për aktivitete nuk mundemi me bërë plane dhe këtë mund ta bënë Ministria e Planifikimit Hapësinorë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT 2024 -2029 PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- raporti i auditimit për vitin 2022 ka rezultuar me pesë të gjetura, dy prej tyre kanë qenë të përsëritura, dy gjysmë të përsëritura dhe një prej tyre e gjetur e re. Prej këtyre pesë të gjeturave e kemi gjetjen e parë e cila kishte të bëjë me tejkalimet në furnizim nga sasi dhe komunalit e cila është tërësisht e zbatuar. E gjetura e dytë ka të bëjë me vonesën e obligimeve financiare, kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar. E gjetura e tretë rritja e llogarive të arktueshme, kjo e gjetur është e zbatuar tërësisht. E gjetura e katërt është zotimet e mjeteve dhe urdhërblërjeve në SIMFK pas pranimit të faturave, është zbatuar tërësisht. E gjetura e fundit është përbërja jo e plotë e komisionit dhe përdorimit jostandardë i formularëve në procesin e mbështetjes financiare të organizatave joqeveritare, edhe kjo e gjetur është plotësisht e zbatuar.

Sherif Berisha thekson:- unë asnjë herë nuk e dëgjova që mos të ketë edhe pjesërisht apo gjysmë të zbatueshme por pse nuk planifikohen gjërat me rregull që mos me ardhur rekomandimet apo vërejtjet prej zyrës kombëtare të auditimit.

Lindita Ballazhi thekson:-çdo herë do të ketë të gjetura prej anës së zyrës kombëtare të auditimit sepse jo çdo herë mundet të punohet në bazë të ligjeve dhe rregulloreve sepse çdo herë s'ke alternativë tjetër dhe gjithë këto të gjetura që kanë rezultuar për vitin 2022 nuk janë shkelje të rënda. Në krahasim me vitin 2021 që kanë qenë nëntë të gjetura që prej tyre ka pasur shkelje ligjore nëpër konkurse dhe nëpër procedura të tjera, këto janë rekomandime. Jemi ndër komunat që kemi më së paku të gjetura.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- këshilli komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023 ka mbajtur gjashtë mbledhje dhe kryesues i këshillit është Kryetari i Komunës. Në material i keni të gjithë përfaqësuesit të cilët kanë marr pjesë . Në material i keni të gjitha temat të cilat janë diskutuar.

Sherif Berisha thekson:- çka është ndërmarr konkret te çështja e dukurive negative.

Sevdi Dernjani thekson:- është temë e gjerë çështja e trajtimit të dukurive negative dhe është kompetencë komplet që i takon Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ne si komunë është e rrugës që ti trajtojmë këto çështje dhe të sensibilizohemi me ligjërata përmes policisë nëpër shkolla e kështu me radhë, ndërsa për identifikimin e këtyre dukurive është Ministria përkatëse e cila është përgjegjëse për këto çështje.

Kryesuesi thekson:-në takim më këshillin komunal për siguri në bashkësi kur diskutohen këto çështje është mirë që të merren më me seriozitet këto çështje sepse me sa vërehet nuk ka diçka që është duke u marr seriozisht me çështjet. Diskutohet çështja e Sirianëve të cilët e kalojnë kufirin në mënyrë ilegale, ndërsa çdo ditë i shohin te marketi Besa dhe kjo nuk është problem komunal por është problem shtetërorë, ndërsa çështja e dukurive negative dhe çështja e vjedhjeve unë nuk di që është dikush në procedurë apo ka marr ndonjë iniciativë që policia ju ka drejtuar që nuk ka mundësi me luftuar këtë dukuri por me përcjell më lartë te organet përgjegjëse, mirëpo e qesin çdo herë që është në rregull , a në fakt një lojë futbollit zhvillohet në Han të Elezit dhe një tifoz e gjuajtur automjetin me gurë dhe policia shumë seriozë e ka marr këtë çështje dhe nxënësit tu dashtur me i marr në pyetje në shkollë apo t'i intervistuar që me gjetur se kush e ka bërë . Kjo të lenë me kuptuar se nuk po bëhet puna sa duhet aty ku është e nevojshme . Është mirë të diskutohet në takim që me marr veprime më konkrete dhe me u marr më seriozisht kjo çështje .

Sherif Berisha thekson:- qytetarët kanë shqetësime sepse gjatë kryerjes së shërbimeve në Stacionë Policorë, polici i kanë pyetur se a ishit te fusha e futbollit dhe mendoj që kjo nuk është në rregull.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Raportimi i punës së Këshillave Lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyrë Kalisi thekson:- është raport që e kemi hartuar së bashku me Kryetarët e këshillave lokale të cilët i kanë paraqitur kërkesat e tyre të cilat përfshijnë çështje të ndryshme në komunë duke u nisur prej projekteve infrastrukturore, shërbimet teknike administrative, shqetësimet të cilat i kanë pasur për energjinë elektrike. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket këshillave të fshatrave në qendër të Hanit të Elezit nuk keni këshill dhe besoj që janë pjekur kushtet me ndërmarr diçka në këtë drejtim për arsye se qendra e Hanit të Elezit dhe Lagjia e re nuk janë të përfaqësuar.

Natyra Kalisi thekson:-takimi i parë me këshillat e fshatit është mbajtur me datë 07.03.2024 dhe kam komunikuar me kryetarin në fjalë, ka kërkuar me dhënë dorëheqje që të njëjtën gjë e ka bërë përmes një shkrese zyrtare përmes imell adresës të cilën e kemi pranuar si dorëheqje dhe pas muajit të Ramazanit me filluar me zgjedhjen.

Kryesuesi thekson:- dorëheqjen që e ka paraqitur dua ta shohë edhe unë . Te çështja e pagesave kërkoj sqarim .

Natyra Kalisi thekson:- ta përcjelli në imell adresë. Çështja e pagesave jemi mundura me marr në shabllonë prej komunës së Prishtinës se si ata e kanë zgjedhur këtë çështje dhe kemi kërkuar që me hyjë në sistem pagesa e mbledhjes së parë dhe pastaj me filluar me mbledhje të tjera.

Xhevahir Dernjani thekson:- sa janë të kënaqur me raportin e viti 2023 dhe sa janë duke punuar si këshilla të fshatrave për komunitetin duke parë parasysh adresat të cilat vijnë në Kuvend.

Natyra Kalisi thekson:- kryetari i këshillit të fshatit Gorancë ka qenë i kënaqur me çështjen e funksionalizimit të ujit në fshatin Gorancë po ashtu edhe projektet e tjera të cilat janë realizuar në fshatin Gorancë dhe Rezhancë. Shqetësimi kryetarit të këshillit të fshatit Gorancë është çështja e furnizimit të energjisë elektrike. Kryetari i këshillit të fshatit Seçishtë ka qenë i kënaqur me realizimin e projektit të e mbjelljes së pishave dhe shqetësime ka për çështje të energjisë elektrike dhe për hedhjen e mbeturinave. Kryetari i këshillit të fshatit Paldenicë ka pasur lëvdata në lidhje me çështjen e ndriçimit publik dhe investimet të cilat janë bërë në fshatin Paldenicë dhe kërkesë ka për çështjen e kanalizimeve atmosferike te një pjesë e fshatit Paldenicë i dhe me rrjetin elektrik.

Kryesuesi thekson:- administratori i fshatit Seçishtë nuk ka potencuar ashtu siç po potenconi ju por ai vazhdimisht është munduar me bashkëpunuar me ju si drejtoreshë dhe me policinë por nuk ka pasur rezultat por këshilli i fshatit është munduar me vullnetin e vetë pozitivë për me punuar diçka për fshatë. Është dëmtuar mbjellja e pishave dy apo tri herë dhe në ato vende që nuk është e mbuluar me kamerë por në ato vende ku mbulohen prej kamerave dhe kryetari i këshillit drejtohet te ju e ju i rekomandoni për në polici ata potencojnë që nuk mundemi me i kontrolluar kamerat.

Natyra Kalisi thekson:-nuk kemi qasje në kamerat e sigurisë ne e kemi zhvilluar projektin dhe kamerat janë në menaxhimin e tyre dhe nuk janë në kompetencat tona.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTIMI I PUNËS SË KËHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8.Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- propozim vendimi ka të bëjë me shpalljen me interes publik të një pjese të parcelë me numër P-73317019-01378-0 në sipërfaqe prej 9234 m² (sipërfaqe e përgjithshme e parcelës 13525 m²) e cila planifikohet për ndërtimin e deponisë së mbetjeve të ngurta . Ju e dini që komuna jonë nuk ka deponim të mbeturinave të ngurta, po ashtu ka probleme me pronësi të tokave për shkak se nuk kemi ndonjë tokë të përshtatshme, andaj jemi përcaktuar për këtë parcelë . Pas shpalljes me interes të përgjithshëm të kësaj parcele do t'i drejtohem qeverisë për marrje të pëlqimit për shfrytëzimin e kësaj parcele apo bartjen e kësaj parcele në pronësi të komunës me qëllim të ndërtimit të deponisë për trajtimin dhe deponimin e mbetjeve të ngurta nga rrënimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore.

Kryesuesi thekson:- a e keni pëlqimin prej banorëve për këtë çështje.

Nexhmedin Daci thekson:- është një raport, procesverbal i administratorit të fshatit Gorancë, kanë mbajtur takim atje dhe parimisht kanë dhënë pëlqim por për mbledhjen e ardhshme kësaj kërkesë do të ja shtojë procesverbalin dhe një raport të Kryetarit e cila ka me qenë pjesë për me ju drejtuar Qeverisë për me na dhënë pëlqim por për mbledhje të Kuvendit do tu a përcjelli.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHHËM TË PRONË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hyriete Isufi thekson:-deklarimi i pasurisë a bëhet tash, a keni ndonjë informacion.

Kryesuesi thekson:- duhet ta bëni se afati është deri më datën 31.03.2024. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 13:01.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

për 



Kryesuesi i Kuvendit
Elërim Shkreta

